

community

The New Apostolic Church around the world

02/2026/AI

Gjithshka e re me Krishtin

Kryeartikulli

Një Perëndi e dashurisë
dhe e mëshirës

Shërbesa fetare

Verë e re, jetë e re

Arsimimi

nac.academy – dixhital dhe
internacional

New Apostolic Church
International



■ Kryeartikulli

- 3** Një Perëndi e dashurisë dhe e mëshirës

■ Shërbesa fetare

- 4** Verë e re, jetë e re

■ Këndi i fëmijëve

- 10** Mrekullia e Pentakostit
12 Për vizitë tek Abigale në Diamond City (Kanada)

■ Arsimimi

- 14** nac.academy – dixhital dhe internacional

■ Lajme globale

- 18** Kur besimi te Zoti merr formë

Një Perëndi e dashurisë dhe e mëshirës

Të dashur vëllezër dhe motra,

Ringjallja e Jezu Krishtit është parimi qendror i besimit të krishterë, besimit tonë, dhe nëpërmjet saj Perëndia konfirmoi doktrinën dhe personin e Jezu Krishtit.

Jezu Krishti erdhi dhe i shpalli njerëzimit një doktrinë, një mësim të pashoq. Ai zbuloi natyrën e vërtetë të Perëndisë; ai u tha njerëzve se Perëndia është Ati juaj, se ai është një At i dashur. Ajo që ka rëndësi për të nuk është thjesht respektimi i disa urdhërësive, rregullave dhe ligjeve. Ai i kushton vëmendje zemrës suaj dhe dashurisë suaj. Ai është shumë afër jush; ai kujdeset për ju. Ai është një Perëndi i mëshirës. Ky është Perëndia ynë. Jo ai që ndëshkon. Jo ai që kërkon hakmarrje.

Nëpërmjet ringjalljes, Perëndia vërtetoi se Jezusi është vërtet Biri i tij i dashur. Perëndia u kujdes për të gjatë gjithë jetës së tij. Por përparësia ishte të ndihmonte Jezu Krishtin në mënyrë që ai, si njeri, të mund të hynte në Mbretërinë e Perëndisë dhe të kishte bashkim të përjetshëm me të.

Ky ishte Ati i Jezu Krishtit. Dhe ky është Ati ynë. Ne besojmë se Perëndia na do, jo sepse na jep shumë para, jo sepse zgjidh çdo problem që kemi. Dashuria e Tij është se na lejon të qëndrojmë besnikë deri në fund dhe të hyjmë në mbretërinë e tij. Ne e dimë se ai kujdeset për ne në jetën tonë



Foto: NAKI

të përditshme, por kjo nuk është gjëja më e rëndësishme. Gjëja më e rëndësishme është se ai dëshiron të na ndihmojë të arrijmë jetën e përjetshme.

Të fala të përzemërta, juaji



Jean-Luc Schneider

Verë e re, jetë e re



Photos: NAC Canada

Shërbesë fetare me apostullin kryesor Jean-Luc Schneider të dielën, më 19 tetor 2025, në bashkësinë Kitchener (Kanada)

Marku 2,22

Askush nuk hedh verë të re në kacekë të vjetër. Përndryshe, vera do t'i çajë kacekët dhe si vera ashtu edhe kacekët do të humbasin. Përkundrazi, vera e re hidhet në kacekë të rinj.

Jam i vetëdijshëm se kjo shërbesë fetare në Kanada është e veçantë sepse apostulli i distriktit dhe ndihmësi i tij do dalin në pension dhe do emërohet një apostull i ri i distriktit. Kjo është diçka e veçantë për të gjithë distriktin. Megjithatë, para së gjithash, ne po marrim pjesë në një shërbesë fetare. Kjo shërbesë nuk ka të bëjë me dy shërbëtorët shpirtërorë që po dalin në pension ose me apostullin e ri të distriktit, por ka të bëjë me ju. Ka të bëjë me shpëtimin tuaj, me marrëdhënien tuaj me Perëndinë. Dhe ka të bëjë me mua, me shpëtimin tim, me marrëdhënien time me Perëndinë. Kjo është gjëja më e rëndësishme sot: që të përjetojmë një shërbesë fetare në të cilën Perëndia ju flet juve dhe mua. Ai do të na japë mesazhin që na duhet për të qëndruar besnikë dhe për të qenë gati për Ardhjen e Dytë të Krishtit. Ky është thelbi e kësaj shërbese.

Paragrafi ynë biblik vjen nga një bisedë që Jezusi pati me farisenjtë dhe skribët. Ata e akuzuan atë dhe dishepujt e tij se nuk i respektonin traditat e rëndësishme. Në mënyrë specifike, ata po i referoheshin argjërimit. Jezusi shpjegoi se kishte ardhur për të sjellë një mesazh krejtësisht të ri dhe se ky mesazh i ri nuk përshpallte me traditat e vjetra. Prandaj edhe dha shembëlltyrën e verës dhe kacekëve të verës.

Sot, ne e nënvlerësojmë se sa inovativ ishte ky mesazh për atë kohë. Ishte e vështirë për t'u kuptuar dhe akoma më e vështirë për t'u pranuar. Jezusi tha: "Ju keni dëgjuar... por unë po ju them". Për hebrejntë e devotshëm që i përmbaheshin traditave të tyre, ky ishte një revolucion shpirtëror.

Çfarë ishte e re në lidhje me mesazhin e tij? Së pari, kuptimi i tij për natyrën e Perëndisë. Për hebrejntë, Perëndia ishte sundimtari i tyre, i cili sillej si mbretërit që ata njihnin: Ai nxori ligje, zbatoi vullnetin e tij - nëse ishte e nevojshme, me forcë - dhe ndëshkoi mosbindjen. Ai mbrojti popullin e tij duke shkatërruar armiqët e tyre.

Por Jezusi zbuloi natyrën e vërtetë të Perëndisë: Ai është një At i mirë dhe i dhembshur, një Perëndi dashurie dhe mëshire. Ai fal. Ai i do mëkatarët. Ky ishte një revolucion - dhe i vështirë për t'u pranuar.

Jezusi gjithashtu mësoi një kuptim krejtësisht të ri të marrëdhënies midis njerëzve dhe Zotit. Çfarë do të thotë të sillesh drejt ndaj Zotit, domethënë të jesh i drejtë? Për t'u konsideruar i drejtë, një hebre duhej të ndiqte rregullat e ligjit dhe traditat. Bëhej fjalë për zbatimin e rregullit të duhur në kohën dhe mënyrën e duhur. Pastaj dikush fitonte bekimin e Zotit. Ky ishte kuptimi i drejtësisë në Besëlidhjen e Vjetër.

Jezusi shpjegoi se respektimi i rregullave dhe traditave nuk ishte i mjaftueshëm. Ajo që kishte rëndësi ishte qëndrimi i zemrës - ishte e rëndësishme të doje Zotin dhe të afërmin tënd. Por kjo përbënte një problem: Ky qëndrim i zemrës nuk duket shumë nga jashtë. Të gjithë mund ta shohin kur ndjek ligjin, por dashuria për Zotin dhe të afërmin është më e vështirë për t'u njohur, për t'u kuptuar.

Jezusi bëri thirrje për një mënyrë krejtësisht të re të të menduarit: Njerëzit duhet të ndryshojnë qëndrimin e zemrave të tyre - gjithçka duhej të ishte e re.



Fëmijët përshëndesin apostullin kryesor me një këngë pas mbërritjes së tij.



Kësaj iu shtua një kuptim krejtësisht i ri i bekimit të Zotit: Njerëzit në atë kohë kishin një ide të qartë se çfarë ishte bekimi: Zoti e shpërbleu bindjen e njerëzve me paqe dhe begati, dhe të drejtët me një jetë të mirë. Anasjelltas, qëndronin ata që nuk e meritonin atë, sepse kishin vepruar gabim.

Jezusi e ndryshoi rrënjësisht këtë kuptim. Në Lumnitë, ai bekoji të varfrit, të shtypurit dhe të persektuarit. Për të, bekimi nuk kishte më të bënte me mirëqenien tokësore, por me jetën e përjetshme - bashkimin e përsosur me Perëndinë. Dhe ky bekim nuk mund të fitohet, por merret vetëm nëpërmjet hirit. Edhe ata që e duan Perëndinë dhe të afërmin e tyre me gjithë zemër duhet të kërkojnë me përlësi hir. Për shumë njerëz, kjo shkatërroi të gjithë themelin e besimit të tyre. Ata e kishin mësuar ndryshe.

Jezusi gjithashtu ndryshoi kuptimin e qëllimit të besimit. Për hebrenjtë, ai konsistonte në të qenit një person i

devotshëm që sillej drejt ndaj Perëndisë dhe të afërmit të tyre. Për Jezusin, kjo nuk ishte e mjaftueshme. Ai kërkoi vetëmohim, të bëheshin një krijesë e re dhe të përputheshin me shembullin e tij - një doktrinë krejtësisht të re.

Dhe së fundmi, ai foli për një kuptim të ri të popullit të Perëndisë. Nuk ishte më vetëm Izraeli, por një popull

nga të gjitha kombet dhe traditat, i përbërë nga besimtarë nga të gjitha sferat e jetës, të cilët, pavarësisht të gjitha dallimeve të tyre, janë një - të bashkuar nga besimi i tyre në Krishtin.

Imagjinoni çfarë revolucioni ishte ky për Izraelin. Jezusi kërkoi një mënyrë krejtësisht të re të të menduarit: Njerëzit duhej të ndryshonin qëndrimet e tyre - gjithçka duhej të ishte e re.

Mësimet e Krishtit nuk janë vetëm të reja; ato janë universale dhe të vlefshme përjetësisht. Ato nuk kërkojnë përshtatje. Ligji i Moisiut gjithmonë është dashur të përshtatet - dhe ende duhet të jetë - ndaj rrethanave të jashtme: tabernakulli

*Le t'i qëndrojmë
besnikë Krishtit
dhe le të mos bëjmë
asnjë kompromis
me mëkatën.*



në shkretëtirë, ligji i hebrenjve, në Jerusalem, Tempull; kudo tjetër, sinagogë.

Por Jezusi tha: “Qielli dhe toka do të zhduken, por fjalët e mia nuk do të zhduken kurrë” (Mateu 24,35). Ungjilli i tij vlen për të gjithë njerëzit, në çdo kohë, në të gjitha kushtet. Ajo që thotë ai është e vlefshme përjetësisht. Dhe ky mesazh është: Për të marrë jetën e përjetshme, duhet të lindësh përsëri nga uji dhe Fryma, të bëhesh pjesë e Kishës së Krishtit, të ndjekësh apostujt e Jezusit dhe të marrësh Darkën e Shenjtë. Ne i përmbahemi fort kësaj. Kjo nuk ka nevojë të përshtatet ose të ndryshohet, kjo është e vërteta e Jezu Krishtit.

Megjithatë, jam disi i shqetësuar sepse shoh se kjo risi radikale e Ungjillit i pengoi të krishterët atëherë, ashtu siç po bën edhe tani. Kjo ishte shumë për ta, dhe ata duan të kthehen në traditat e vjetra. Edhe Pali duhej t'i këshillonte Galatasit të qëndronin besnikë ndaj Ungjillit dhe të mos i nënshtroheshin përsëri zgjedhës së skllavërisë - zgjedhës së mëkatit.

Kujtoni Izraelin: Zoti e çliroi popullin nga zgjedha e Egjiptianëve. Ata ishin të lumtur dhe të lirë. Por pas një kohe, ata harruan skllavërinë dhe kujtuan vetëm gjërat e mira të jetës në Egjipt - tenxheret me mish dhe bukën.



Majtas: apostulli i distriktit Mark Woll ndihmës apostulli i distriktit Frank Dzur do të dalin në pension
Djathtas: Arnaud Martig do të ngarkohet me detyrën e apostullit të distriktit



Shumë të krishterë ndihen sot njësoj: Jeta do të ishte më e lehtë nëse do të bënin kompromise të vogla me mëkatën. Jezusi është me të vërtetë mjaft kërkues në këtë drejtim. Sigurisht që nuk kemi pse të bëni gjithçka që ai thotë njëqind për qind... Jo. Le t'i qëndrojmë besnikë Krishtit dhe të hedhim poshtë çdo kompromis me mëkatën.

Zoti shpesh e akuzonte Izraelin se i drejtohej atij vetëm në kohë nevoje: Kur gjërat shkonin keq, ata bënin sakrificë në mënyrë që ai të ndihmonte. Sapo problemi zgjidhet, marrëdhënia e tyre me Zotin lirohej përsëri. Disa të krishterë gjithashtu bien sot në këtë model. Krishti u bëri thirrje dishepujve të tij të linin gjithçka dhe ta ndiqnin. Për shumë, kjo është shumë radikale. Ata e ndjekin Jezusin vetëm për të marrë ndihmën e tij në këtë jetë. Ata vijnë te Zoti ashtu siç dikush viziton një teze të vjetër - për të qetësuar ndërgjegjen e tyre, për të marrë ndihmë ose me shpresën e një trashëgimie.

Pa paragjykuar: Shumë fjalime, të ashtuquajturat predikime të krishtera, merren pothuajse ekskluzivisht me çështje tokësore. Nëse bën këtë apo atë, nëse ndjek ligjin, do të bekoresh. Shiko sa i pasur jam. Nëse bën të njëjtën gjë, edhe ti do të jesh i pasur, sepse unë jam i bekuar. Nëse respekton rregullat, mund të bëhesh njeri i mirë. Jeta do të ishte shumë më e mirë nëse të gjithë do t'i ndiqnin këto rregulla... Dimensionin e jetës së përjetshme ka humbur. Gjithçka ka

të bëjë me këtë botë, me bekimet tokësore - duke u kthyer në Beslidhjen e Vjetër. Aspekti i transformimit, aspekti i jetës së përjetshme, nuk luan më rol. Çfarë turpi! Jezusi vdiq për të na dhënë jetën e përjetshme - jo për të zgjidhur problemet tona tokësore, jo për të qeverisur vendin, jo për të na bërë të pasur. Nëse kjo do të ishte e gjitha për të cilën bëhej fjalë, nuk do të kishim nevojë për një Beslidhje të Re; e Vjetra do të mjaftonte.

Disa të krishterë e pëlqejnë librin e rregullave të Beslidhjes së Vjetër - idenë se duke bërë gjënë e duhur, automatikisht merr bekime. Është më e lehtë të ndjekësh listat sesa të jetosh sipas urdhërësave të Beslidhjes së Re. Nuk ka një listë të gatshme atje që të tregon se çfarë duhet të bësh dhe kur do të bekoresh. Urdhëresa e Jezusit është thjesht: Duaje Perëndinë dhe duaje të afërmin tënd. Ne duhet ta shqyrtojmë vazhdimisht veten për të ditur se si duhet të sillemi ndaj Zotit dhe të afërmit tonë në momentin e tanishëm. Dhe kur më në fund e kupton se nuk mund të duash kurrë si Krishti, është e pakëndshme. Duket më e



Ndhimës apostulli kryesor
Helge Mutschler



Ndhimës apostulli i distriktit
Arnaud Martig



Apostulli i distriktit Mark Woll

thjeshtë të kthehesh te rregullat e vjetra - por kjo nuk është Beslidhja e Re.

Adami i vjetër brenda nesh gjithmonë dëshiron të kthehet prapa. Ne jemi të destinuar të bëhemi të rinj, por Adami i vjetër dëshiron të qëndrojë. Ai beson se mund ta fitojë shpëtimin përmes veprave të mira. Zoti është i detyruar ta japë atë. Dhe ai nuk e pranon që Zoti u jep të njëjtin hir të gjithëve. Ai e gjen të padrejtë që të tjerët, që janë më pak besnikë, marrin të njëjtën gjë si ai. Mëkatarët duhet të ndëshkohen, mendon ai.

Por Zoti thotë: Kjo nuk varet nga ju. Unë shpëtoj këdo që dua të shpëtoj. Kjo është Beslidhja e Re. Megjithatë, Adami i vjetër ushqen egon e tij. Ai ua imponon mënyrën e tij të jetesës dhe të të menduarit të tjerëve dhe kërkon që ata ta konfirmojnë atë. Edhe në Kishë: evropianët duan një Kishë evropiane, afrikanët një afrikane, amerikano-veriorët duan një kishë amerikano-veriore, amerikano-jugorët një amerikano-jugore. Pas kësaj qëndron dëshira: Unë nuk dua të ndryshoj. Unë përcaktoj se kush jam dhe të gjithë të tjerët duhet të më përshtaten mua. Por ku e lë kjo idenë e ndjekjes pas të Krishtit dhe përpjekjes për t'u bërë si ai? Kjo harrohet. Të gjithë janë aq të preokupuar me idenë e tyre "Ky jam unë" sa që qëllimi i vërtetë humbet. Krishti na thërret të mohojmë veten për t'u bërë si ai. Uniteti i Kishës mbështetet në vendimin tonë të përbashkët për të ndjekur pas Jezu Krishtin. Por Adami i vjetër i reziston kësaj.

Vëllezër dhe motra, këto janë vetëm disa gjëra për të cilat duhet të mendojmë. Krishti solli një doktrinë krejtësisht

të re: një imazh të ri të Perëndisë, një marrëdhënie të re me Perëndinë, një kuptim të ri të bekimit, thirrjen për një krijesë të re dhe një popull të ri. Deri më sot, shumë të krishterë e kanë frikë këtë ide - është shumë e re, shumë e vështirë, shumë kërkuese për ta.

Ne u bëmë të krishterë, u bëmë apostolikë të rinj, sepse dëshirojmë jetën e përjetshme. Për këtë, ne e dimë: Se duhet të bëhemi një krijesë e re. ajo filloi me rilindjen tonë nëpërmjet marrjes së ujit dhe të Frymës së Shenjtë. Ky proces vazhdon. Për këtë, ne kemi nevojë për Fjalën e Perëndisë, Darkën e Shenjtë dhe shoqërinë e vëllezërve dhe motrave. Dhe ne po punojmë për t'u bërë më shumë si Krishti.

Sa më shumë që bëhemi si Krishti, aq më e lehtë do të jetë të jemi një në Krishtin pavarësisht të gjitha dallimeve tona.

MENDIME KYÇE.

Jezu Krishti na zbulon natyrën dhe vullnetin e Perëndisë. Mësimet e Tij janë të vlefshme përjetësisht. Ato synojnë të na japin jetën e përjetshme. Ne e duam Perëndinë dhe të afërmin tonë. Uniteti ynë bazohet në dëshirën tonë të përbashkët për t'u bërë si Krishti.

MREKULLIA E PENTAKOSTIT

SIPAS VEP. TË APOST. 2,1-47

Pesëdhjetë ditë pas Pashkëve, në Ditën e Pentakostit, apostujt u mbledhën në një shtëpi me burrat dhe gratë që kishin ndjekur Jezusin pas. Ata po prisnin që fuqia e Frymës së Shenjtë të vinte mbi ta, siç u kishte thënë Jezusi.



Papritur, një zhurmë e fortë u dëgjua. Një erë e fuqishme erdhi nga qielli dhe mbushi tërë shtëpinë. Gjuhë si zjarri u vunë mbi secilin prej tyre dhe dishepujt u mbushën me Frymën e Shenjtë. Ai i aftësoi ata të tregonin për veprat e mëdha të Perëndisë në gjuhë të ndryshme.

Në të njëjtën kohë, pelegrinë nga Mesopotamia, Azia, Egjipti, Libia dhe Roma po vizitonin qytetin. Ata kishin ardhur në Jerusalem për të ofruar flijime në Tempull.

Shumë pelegrinë erdhën

në shtëpinë ku dishepujt, të mbushur me Frymën e Shenjtë, po u flisnin atyre. Ata vunë re diçka të jashtëzakonshme: Secili e dëgjoi mesazhin në gjuhën e vet.

Dëgjuesit u çuditën: "Si është e mundur kjo? Këta njerëz janë nga Galilea. Si mund të flasin në gjuhë të tjera?"

Disa menduan se dishepujt mund të ishin të dehur.

Pastaj foli Pjetri. Ai tha:

"Askush këtu nuk është i dehur. Një mrekulli e madhe po ndodh sot. Perëndia ka derdhur Frymën e tij të Shenjtë,

ashtu siç premtoi nëpërmjet profetëve.”

Pastaj Pjetri u tregoi atyre për Jezusin, se si u kryqëzua dhe u ringjall nga të vdekurit. Predikimi i Pjetrit i preku thellë njerëzit.

Ata i pyetën apostujt: “Çfarë duhet të bëjmë?”

Pjetri u tha atyre: “Pagëzohuni që mëkatet tuaja të falen dhe të merrni Frymën e Shenjtë.”

Shumë veta i besuan Pjetrit dhe u pagëzuan. Tre mijë njerëz iu bashkuan bashkësisë së krishterë.

Ata qëndruan së bashku, dëgjuan fjalët e apostujve, u lutën dhe ndanë bukën së bashku. Ata ndanë gjithçka që kishin.



PËR VIZITË TEK ABIGALE NË DIAMOND CITY (KANADA)

Apostulli ynë kryesor e ka shpallur "Eshtë koha për të bërë mirë" si moton për vitin që kaloi. Unë e kam zbatuar këtë për një kohë të gjatë deri tani. Për shembull, më pëlqen shumë të ndihmoj fëmijët më të vegjël dhe të moshuarit e bashkësisë sonë. Dhe vitin e kaluar, së bashku me nxënësit e tjerë të shkollës të së dielës dhe të rinjtë nga bashkësia ime, mora pjesë në fushatën "Nata më e Ftohtë e Vitit". Ne mbledhëm para për të pastrehët në Lethbridge.



Emri im është Abigale, jam 13 vjeçe dhe jetoj në Diamond City, Kanada. Kur të rritem, dua të bëhem mësuese dhe të jap mësim në lëndën e matematikës.

Gjithashtu mezi pres të bëhem mësuese e shkollës të së dielës. Këtu mund të më shihni me disa fëmijë të tjerë nga shkolla e së dielës në Lethbridge, bashkësia ku unë marr pjesë.

Kam luajtur violinë për katër vjet. Kam luajtur gjithashtu në bashkësi. Në foto, mund të më shihni në festimin e Krishtlindjeve, ku kam luajtur "Noelin e Parë". Kam fituar tashmë njëfarë përvoja aktrimi në festimet kishtarë, por paraqitja ime e parë publike ishte në rolin e një ariu të zemëruar në një shfaqje shkollore. Gjithashtu më pëlqen të luaj voleyboll dhe basketboll, të bëj ski dhe patinazh në akull, të lexoj dhe të jem kreative me letra punëdore.



Këtu më shihni me familjen time: babain tim Josh, nënën time Michelle, motrën time më të vogël Kaitlyn dhe motrën time më të madhe Olivia. Tani jemi anëtarë të gjeneratës së pestë të Kishës Apostolike të Re. Stërgjyshi i babait tim mori pjesë në shërbesat fetare në Zvicër përpara se të emigronte në Kanada dhe të fillonte jetën me familjen e tij këtu.

Kjo është ndërtesa e kishës në Lethbridge. Besimi Apostolik i Ri erdhi në Kanada nëpërmjet një gruaje të re që emigroi nga Gjermania në zonën pranë Waterloo-s. Shërbesat e para u mbajtën në shtëpinë e saj dhe, për shkak se ajo vazhdonte të ftonte fqinjët, shpejt u formua një bashkësi e vogël.



Gjethet e panjës, në të gjitha variacionet e tyre, janë një suvenir tipik nga Kanadaja. Ky është bërë nga shurupi i panjës. Në Kanada, na pëlqen të hamë petulla me shurup panje për mëngjes ose simite të mbuluara me fara susami dhe lulekuqeje.

Në anglisht, një gjethë panje quhet gjethë Maple. Qeni i familjes sonë quhet gjithashtu Maple, sepse kur erdhi tek ne në vjeshtë shtatë vjet më parë, ngjyra e saj përputhej shumë mirë me gjethet që binin nga pemët. A e dinit ju se gjethja e panjës është e paraqitur edhe në flamurin kanadez?



nac.academy – dixhital dhe internacional

Arsimim i vazhdueshëm e kudo: Kjo është motoja e një programi të ri të ofruar nga Kisha Apostolike e Re Ndërkombëtare, që jepet kryesisht për shërbëtorët shpirtërorë.

Nak.org, nac.today dhe nac.photos kanë pësuar një rritje të re: nac.academy quhet tashmë portali i ri. Ashtu si me dy faqet e tjera të internetit, emri është gjithashtu adresa e internetit. Përdoruesit që hyjnë në nac.academy në shfletuesin e tyre të internetit mund të regjistrohen direkt ose të hyjnë në ëkauntin e tyre ekzistues të kishës (Single Sign-On, SSO).

Në Teori dhe Praktikë

Kujdesi shpirtëror, predikimi, lutja në shërbesat fetare, kujdesi për shpirtat e larguar nga kjo jetë si dhe dhe Të kuptuarit e postit janë kurset që aktualisht janë në dispozicion. Tema të tjera janë në zhvillim e sipër - të tilla si kuptimi i sakramenteve, zgjidhja e konflikteve dhe veprimet bekuese. Ofrohen Linke të drejtpërdrejta për Katekizmin (KNK), Katekizmin në formën Pyetje dhe Përgjigje (KNK

PP), Librin e Liturgjisë dhe Linja Udhëzuese për shërbëtorët shpirtërorë.

Kurset në nac.academy janë aktualisht në dispozicion në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, italisht, indonezish, tagalogisht, suahili, shqip dhe rumanisht. Përkthimet në letonisht, lituanisht dhe portugalisht janë në proces.


Mësoni sipas ritmit tuaj

Mësimet janë të bazuara në multimedia: tekste për t'u lexuar ose dëgjuar, tabela dhe grafikë, video dhe teste me zgjedhje të shumëfishta për të përforcuar materialin. Kushdo mund t'i përfundojë kurset në çdo kohë, kudo, në kompjuterin e tij, tabletin ose smartphone-in, me ritmin e tij. Baza teknike është "Ilias", një platformë me burim të hapur e përdorur ndërkombëtarisht nga universitetet, administrata qeveritare dhe bizneset.

Dhe si ishte në gjendje nac.academy të ndërtonte një gamë kaq të larmishme përmbajtjesh kaq shpejt dhe me kosto efektive? Me ndihmën e IA, sigurisht. Megjithatë, vetëm implementimi audio dhe video përdor inteligjencën artificiale. Përmbajtja bazohet në mësimet dhe shpjegimet zyrtare dhe aktuale të Kishës Apostolike të Re dhe u shqyrtuan dhe u miratuan nga Apostulli Kryesor dhe Grupi i Koordinimit.

Krijimi i mundësive për të gjithë

Trajnimi dhe arsimimi i vazhdueshëm i shërbëtorëve shpirtërorë nuk është i



ri në Kishën Apostolike të Re. Megjithatë, mundësitë për këtë ndryshojnë shumë në mbarë botën. Drejtuesi i projektit e shpjegon këtë në videon e mirëseardhjes në nac.academy.

Takimi i Apostujve të Distriktit e trajtoi gjithashtu këtë çështje në vitin 2023 me një anketë përkatëse. "Në disa zona, ka burime të mira, në të tjera më pak kapacitete dhe mundësi."

Prandaj, apostulli kryesor Jean-Luc Schneider dha miratimin për nac.academy. Gati 400 përdorues nga Afrika, Evropa, Amerika dhe Azia janë regjistruar gjatë fazës fillestare të zhvillimit. 96 përqind u bindën nga programi dhe 97 përqind duan më shumë prej tij. Kushdo që është i interesuar tani mund të formojë mendimin e vet.

Shembull: Moduli mbi shpirtat e larguar nga kjo jetë

"Perëndia nuk është Perëndi i të vdekurve, por i të gjallëve, sepse për të jetojnë të gjithë." (Luka 20,38)

Mirë se vini në kursin e mësimin elektronik "Kujdesi për shpirtat e larguar nga kjo jetë në Kishën Apostolike të Re". Ky kurs ofron njohuri themelore rreth kuptimit dhe praktikës së kujdesit për shpirtat e larguar nga kjo jetë. Pse besojmë se jeta vazhdon edhe pas vdekjes? Dhe çfarë do të thotë kjo për të kuptuarit tonë të shpirtit dhe jetës së re me Perëndinë? Si funksionon hiri dhe shpëtimi i Perëndisë në jetën e përtjeje dhe cila është rëndësia e sakramenteve për të vdekurit? A është e justifikuar shpresa e një ribashkimi me të dashurit tanë dhe si ndryshon të kuptuarit apostolik i ri nga spiritualizmi?

Besimi në jetën e përtjeje

"Sepse ajo që shihet është e përkohshme, por ajo që nuk shihet është e përjetshme." (2 Korintasve 4,18)

Pse besojmë në jetën pas vdekjes?

- Qeniet njerëzore përbëhen nga trupi, shpirti dhe fryma (krahaso KNK 3.3.4).
- Shpirti është thelbi personal i një qenieje njerëzore. Ai

vazhdon të ekzistojë edhe pas vdekjes fizike.

- Pavdekësia e shpirtit është e mishëruar në besimin e Kishës. Kjo do të thotë që qeniet njerëzore janë të qëndrueshme para Perëndisë dhe nëpërmjet saj (krahaso KNK 3.3.2).
- Shkrimi i Shenjtë dëshmon për jetën pas vdekjes, për shembull, në Librin e Urtësisë (Urtësia 3,1, 4) dhe në shëmbëlltyrën e të pasurit dhe Llazarit (Luka 16,19–31).

Gjendja e shpirtit pas vdekjes tregon se sa afër ose larg je nga Perëndia. Vdekja nuk e ndryshon shpirtin - ai mbetet i njëjtë si në këtë jetë. Besimi apo mosbesimi, pajtimi apo papajtueshmëria, dashuria apo urrejtja i formojnë njerëzit jo vetëm në këtë botë, por edhe në botën tjetër. Kjo gjendje trajtohet edhe në shëmbëlltyrën e Jezusit rreth të pasurit dhe Llazarit (krahaso Luka 16,19-31), e cila flet për një vend mbrojtjeje dhe një vend mundimi. Të vdekurit mund të bëhen të vetëdijshëm për gjendjen e tyre. Ata që vuajnë mundime shpresojnë për ndihmë.

Çfarë është shpirti?

"Zoti i jep forcë jetësore krijesës së tij më të çmuar dhe gjithashtu i jep atij një pjesë në atributet hyjnore si dashuria, personaliteti, liria, arsyeja dhe pavdekësia" (KNK 3.3.2).

- Shpirti duhet të kuptohet si thelbi personal i një qenieje njerëzore. Qeniet njerëzore janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Zotit. Prandaj, personaliteti i tyre vazhdon edhe pas vdekjes - Zoti u jep atyre jetë të përjetshme.

Kurset e nac.academy janë në dispozicion në gjuhë të ndryshme



- Pavdekësia do të thotë: Qeniet njerëzore mbeten - para Zotit dhe nëpërmjet Zotit – të përhershëm, përgjithmonë.

Çfarë është trupi i ringjallur?

- Në ringjallje, një person pajiset me një trup të ri, shpirtëror (krahaso KNK 3.3.4).
- Ky trup nuk është më një trup fizik tokësor, por një "trup shpirtëror" (1 Korintasve 15,44), një formë e re mishërimi në të cilën ruhet ekzistenca e mëparshme fizike.
- Vetëm me bashkimin e shpirtit dhe trupit të ringjallur bëhet e mundur bashkimi i plotë me Perëndinë, nëpërmjet të cilit përfundon shpëtimi i njerëzimit.

Shpresa jonë për jetën pas vdekjes mbështetet në besimin se Perëndia i jep shpirtit pavdekësi dhe bën që ai të ringjallet. Sipas të kuptuarit të besimit apostolik të ri, vullneti i Perëndisë për shpëtim shpirtëror vlen për të gjithë njerëzit - të gjallët dhe të vdekurit. Doktrina për shpirtrat që tashmë janë larguar nga kjo jetë bazohet në këtë themel: Në doktrinën se edhe të larguarit nga kjo jetë mund të marrin shpëtim në Krishtin.

Sakramentet për shpirtrat e larguar nga kjo jetë

Veprimi në këtë jetë, efekti në botën e përtejme?

Shpirtrat e larguar nga kjo jetë ende mund të zgjedhin shpëtimin; për këtë, ata kanë nevojë për hirin e Zotit. Por si e justifikon këtë praktika apostolike e re e administrimit apo

dhurimit të sakramenteve në këtë jetë për ata të botës së përtejme?

Sakramentet në këtë jetë për botën e përtejme

Në Jezu Krishtin, vetë Zoti u bë njeri dhe përjetoi vdekjen tokësore me vuajtje dhe dhimbje. Përmes sakrificës së Krishtit, u vendos gjithçka që njerëzimit i duhet për të gjetur shpëtimin. Kështu, njerëzit duhet të pagëzohen me ujë, të marrin dhuntitë e

Frymës së Shenjtë përmes vendosjes së duarve mbi kokat e tyre nga një apostull i gjallë dhe të përjetojnë prezencën e Zotit dhe dashurinë e tij në ndarjen e Darkës së Shenjtë.

Sakramentet gjithmonë kanë një aspekt material, të dukshëm dhe një anë të padukshme: shenjën e dukshme dhe veprimin e padukshëm të Zotit. Kjo vlen edhe për ata që tashmë nuk rrojnë. Kur sakramentet administrohen në mënyrë zëvendësuese në tokë, kjo ka një efekt tek shpirtrat që dëshirojnë atë edhe në botën e përtejme. Ata fitojnë qasje në hirin e Zotit dhe mund të marrin shpëtim.

Mbetet vendimi sovran i Zotit se kush e merr shpëtimin. Askush nuk e di se cilët shpirtra në jetën e përtejme do t'i pranojnë sakramentet.

Roli i Apostujve

Apostujt veprojnë në vend të Krishtit dhe në emër të tij (KNK 7.6 dhe 9.6.3). Ata vazhdojnë veprën e Jezusit siç përshkruhet në 1 Pjetrit 3,19-20: Vetë Krishti u shpalli Ungjillin të vdekurve - Apostujt veprojnë sot në të njëjtin mision.

Tri herë në vit, apostulli kryesor dhe apostujt e distrikteve (ose apostujt e emëruar prej tyre) kryejnë shërbesa fetare për shpirtrat e larguar nga kjo jetë. Në këto shërbesa, sakramentet administrohen në të njëjtën mënyrë si zakonisht.

Në shërbesat për shpirtrat e larguar nga kjo jetë, në të cilat nuk administrohen sakramente, ofrohet një lutje

ndërmjetësimi. Kjo lutje shpreh mirënjohje që nëpërmjet sakrificës së Jezu Krishtit, edhe ata që kanë vdekur të pashpëtuar mund të marrin shpëtim. Duke marrë sakramentet, krijohet parakushti që shpirtrat të kenë bashkim me Jezu Krishtin dhe të arrijnë frytet e para, në mënyrë që në fund të fundit të marrin jetën e përjetshme, domethënë, bashkim të përsosur me Trininë e Perëndisë. Në lutjen ndërmjetësuese, ne lutemi për shpirtrat e pashpëtuar, që ata të mund të marrin besim dhe forcë për t'u kthyer te Krishti me bindje dhe përlulesi. Le të ndiejnë një mall për hirin e Perëndisë dhe për sakramentet, dhe kështu të përjetojnë shpëtimin.

Ringjallja e të Vdekurve

Shpresë për përmbushje

Administrimi i sakramenteve për të vdekurit është i lidhur ngushtë me besimin në Ringjallje.

Çfarë do të thotë Ringjallje?

Ringjallja e të vdekurve është një nga parimet qendrore të besimit në Kishën Apostolike të Re. Ajo është një shprehje e shpresës për jetën e përjetshme në bashkimin me Perëndinë.

Në Ardhjen e Dytë të Krishtit, të vdekurit do të ringjallen (KNK 10.1.2). Shpirtrat e të vdekurve do të marrin një trup ringjalljeje, një trup shpirtëror që nuk i nënshtrohet më prishjes tokësore. Përmes ringjalljes, një person rifiton tërësinë e tij origjinale - trupi dhe shpirti ribashkohen.

Vetëm kur shpirti i të vdekurve është i pajisur me trupin e ringjallur është i mundur shpëtimi i plotë, sepse atëherë ata janë si Jezu Krishti, fryti i parë i atyre që tashmë janë larguar nga kjo jetë (1 Korintasve 15,20).

E lidhur me Ringjalljen është edhe shpresa për t'i parë të vdekurit përsëri. Kisha përfshin si të gjallët ashtu edhe të vdekurit. Të gjithë shpresojnë në jetën e përjetshme me Perëndinë. Në Ringjalljen dhe bashkimin përfundimtar me Krishtin, do të jetë e mundur të lidhemi në një mënyrë të re - me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin. Asnjë koncept njerëzor nuk është më parësor, por përkundrazi do mbetet në plan të parë bashkimi i përsosur i të gjithë të shpëtuarve në mbretërinë e Perëndisë.

Çfarë nuk është jeta e shpirtrave të larguar nga kjo botë

Nuk është një praktikë spiritualiste

Jeta e shpirtrave të larguar nga kjo botë në Kishën Apostolike të Re nuk duhet të ngatërrohet me spiritualizmin.

Spiritualizmi përpiqet të kontaktojë të vdekurit për të marrë informacion ose njohuri rreth jetës së përtejme. Të vdekurit bëhen objekte të kuriozitetit njerëzor, dhe jeta e përtejme shihet si një dimension i eksplorueshëm i kësaj jete. Disa pasazhe biblike paralajmërojnë në mënyrë të qartë kundër praktikave të tilla (shih Ligji i Përtërirë 18,9-12 dhe 1 Samuelit 28,7-20).

Megjithatë, interesi i vetëm i shpirtrave të larguar nga kjo botë është t'ua bëjë të arritshëm shpëtimin të gjithë atyre shpirtrave.

Nuk është një Vazhdim i Adhurimit të Paraardhësve

Jeta e shpirtrave të larguar nga kjo botë gjithashtu nuk duhet të ngatërrohet me adhurimin tradicional të paraardhësve.

Në adhurimin e paraardhësve, të vdekurve shpesh u atribuohet një rol ndërmjetësues midis Zotit dhe njerëzimit. Të vdekurit nderohen, dhe ofertat dhe ritualet përdoren për të kërkuar favorin e tyre. Ekziston një besim se paraardhësit ndikojnë në jetën e pasardhësve të tyre - për mirë ose për keq - në varësi të faktit nëse u tregohet nderim i mjaftueshëm ose jo.

Sipas besimit apostolik të ri, vetëm Jezu Krishti është ndërmjetësi midis Zotit dhe njerëzimit. Ne nuk kemi nevojë për të vdekurit - ata kanë nevojë për shpëtimin e Zotit në Jezu Krishtin.

Përkujtimi i të vdekurve nuk është një formë nderimi për ata, por më tepër një shprehje e dashurisë së Zotit për të gjithë njerëzit - të gjallë dhe të vdekur.

Shërbëtorët shpirtërorë dhe individët e interesuar mund të regjistrohen nëpërmjet Linkut www.nac.academy.

Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Switzerland

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Simon Heiniger



NÃO TEMAS
APENAS CRÊ!



Jangan Takut,
Percaya Saja!

GKB ASIA TENGGARA 2026

Kur besimi tek Zoti merr formë

Valët kërcënojnë, duart mbajnë dhe ndihmojnë: Këto janë motivet më të zakonshme në logot për moton e vitit 2026 - këtu janë dizenet zyrtare nga Zonat e Apostujve të Distriktit.

Një valë ngrihet mbi një grup njerëzish. Por ata po mbahen nga një dorë e madhe. Kështu e vizualizoi Kisha Apostolike e Re në Afrikën e Jugut moton për vitin, "Mos ki frikë, vetëm beso!"

Ideja e valës është frymëzuar nga historia e Jezusit që qetëson stuhinë. Valët simbolizojnë sfidat shpirtërore dhe natyrore që mund të shkaktojnë frikë dhe ankth. Dora përfaqëson praninë e vazhdueshme të Zotit, e cila i forcon dhe i mbron njerëzit, edhe kur valët përplasen.

I mbartur përmes ulje-ngritjeve

Një ide shumë e ngjashme vjen nga një cep krejtësisht i ndryshëm i globit: Logoja nga Kanadaja përshkruan një

varkë me vela që lundron në ujëra të stuhishme. Shpjegimi është: "Jeta sjell stuhi të vërteta, frika të vërteta dhe sfida të vërteta që mund të na bëjnë të prekshëm dhe të pasigurt."

Varka është e vogël dhe deti është i gjerë, por Jezu Krishti është me të Tijët. "Ai ndriçon rrugën tonë - duke na udhëhequr përmes stuhisë dhe duke na përgatitur për një të ardhme të përsosur."

Valë, një familje, sipër tyre një kryq dhe një kupolë. Kështu e ka interpretuar temën distrikti i Republikës Demokratike të Kongos Juglindore. Nga trazirat emocionale dhe materiale, besimtarët ngrihen dhe i drejtohen Krishtit. Në këtë mënyrë, ata e dinë se janë të sigurt vetëm nën kujdesin hyjnor.



Nën Mbrojtjen e Dorës së Tij

"Qetësohu", thotë dora në qendër të logos nga Republika Demokratike e Kongos Perëndimore. Megjithatë, urdhri nuk u drejtohet njerëzve, por frikës së tyre. Profili i një fytyre njerëzore simbolizon njerëzimin përballë sfidave, shqetësimeve dhe pasigurive. Rrethi blu përreth përfaqëson praninë, dashurinë dhe besnikërinë e kujdesshme dhe mbrojtëse të Zotit. Rrethi në dizajnin nga Zambia/Malawi/Zimbabwe synon të kuptohet në të njëjtën mënyrë. Brenda tij: një vajzë që shtrin dorën lart dhe një dorë e fortë që ulet nga lart. Kjo aludon për histori të ndryshme biblike në të cilat Jezusi në fund tha: "Besimi yt të ka shpëtuar".

Dizajni nga Amerika e Jugut është i vlerësuar. "Mos u frikëso, vetëm beso" - ky është një mesazh kaq i fuqishëm sa vizualizimi ka për qëllim thjesht ta shoqërojë atë, thuhet në shpjegim. Elementi i vetëm grafik është një dorë e hapur. Ajo as nuk imponon asgjë dhe as nuk mban asgjë: ajo pret, ofron, mbështet dhe jep besim. Ajo përfaqëson mbrojtjen, mbështetjen dhe natyrën gjithmonë të pranishme të Atit tonë.

Midis Mburojës dhe Fluturës

Një mburojë blu dhe portokalli me një kryq si emblemë është elementi qendror vizual në konceptin nga Azia Juglindore. Kjo i referohet mburojës së besimit nga Efesianët 6,16. Ngjyra blu përfaqëson paqen dhe besimin, ndërsa portokallia simbolizon guximin dhe shpresën.

Fluturat mes luleve janë përshkruar në dizajnin nga rajoni i Paqësorit Perëndimor. "Krijesat më delikate dhe të brishta të Perëndisë janë shpesh më të prekshmet", thuhet në shpjegim. "Megjithatë, në mjedisin që ai ka krijuar për to, ato jetojnë, lulëzojnë dhe japin një kontribut të qetë, por jetësor në harmoninë e jetës." Sepse: "Fuqia e Perëndisë shpaloset në dobësi" (2 Korintasve 12,9).

Një fëmijë që mëson të ecë, duke u inkurajuar nga babai i tij. Afrika Lindore e ka përfshirë këtë imazh në moton e saj. Për të kapërcyer paralizën e frikës, Ati qiellor gjithashtu i inkurajon fëmijët e tij të bëjnë hapat e tyre të parë duke i besuar atij.

"Mos ki frikë, vetëm beso" e shkruar në gjuhë të ndryshme: Motoja për vitin paraqitet përsëri si një re fjalësh në katër zonat e apostujve të distrikteve evropianë.



Pasqyra

- 05.04.2026 Metz (Francë)
- 12.04.2026 Winnipeg (Kanada)
- 01.05.2026 Makati (Filipine)
- 03.05.2026 Taguohon (Filipine)
- 10.05.2026 Hamm (Gjermani)
- 14.05.2026 Langenthal (Zvicër)
- 17.05.2026 Straßburg (Francë)
- 24.05.2026 Kapstadt (Afrika Jugut)
- 07.06.2026 Luanda (Angola)
- 14.06.2026 Stäfa (Zvicër)
- 21.06.2026 Karlsruhe (Gjermani)
- 28.06.2026 Kinshasa (R. D. Kongo)

New Apostolic Church
International

